



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 3131 Prot.

Tiranë, më 06.11.2023

URDHËR

Nr. 122, datë 06.11.2023

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË 2023-2025”**

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Planit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORIT LARTË I DREJTËSISË





ILD

INSPEKTORI I LARTË
TË DREJTËSISË

PLANI I INTEGRITETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

2023-2025

Miratuar me urdhrin nr. 122, datë 06.11.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të integritet të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”



Ky Plan Integriteti është hartuar në kuadër të Projektit “Përmirësimi i performancës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si institucion kyç për një gjyqësor profesional në Shqipëri” zbatuar nga Qendra Europiane, me mbështetjen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe financuar me fonde të Qeverisë Suedeze.

Hyrje

Shkurtime

ILD – Inspektori i Lartë i Drejtësisë

KLJGJ - Këshillit të Lartë Gjyqësor

KLP - Këshillit të Lartë të Prokurorisë

MFE - Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

KEV- Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit

ILDKPKI – Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

PBA- Plani Buxhetor Afatmesëm

PP – Prokurori i Përgjithshëm

SMAD - Sistemi i menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore

Tabela e Përmbajtjes

<u>Hyrje</u>	3
<u>Shkurtime</u>	3
<u>1. Qëllimi i Planit të Integritetit</u>	5
<u>2. Metodologjia dhe procesi i hartimi të Planit të Integritetit</u>	7
<u>3. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit</u>	9
<u>4. Plani i veprimit</u>	17

1. Qëllimi i Planit të Integritetit

Plani i Integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) u hartua gjatë periudhës shkurt-korrik 2023.

Objektivat e Planit të Integritetit të Zyrës së ILD janë: i) vlerësimi i risqeve të integritetit për të gjitha proceset e punës në institucion, të cilët mund komprometojnë aftësinë e Zyrës së ILD për të kryer funksionin publik në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme e profesionale dhe i faktorëve, që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara; si dhe ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre. Plani i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së rreziqeve, që cenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të, si dhe është një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit. Këto fusha përfshijnë: i) kuadrin ligjor dhe rregullator; ii) planifikimin strategjik dhe buxhetor; iii) menaxhimin financiar; iv) menaxhimin e burimeve njerëzore; v) kontrollin, auditimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit; vi) transparencën; vii) arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve shkresore, si dhe të informacionit e të dokumenteve elektronike; viii) verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Prokurorit të Përgjithshëm (PP); si dhe ix) inspektimit institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë.

Plani i Integritetit për Zyrën e ILD do të shërbejë si një dokument i brendshëm me karakter udhëzues, në të cilin janë përcaktuar objektivat për forcimin e etikës dhe integritetit, që do të udhëheqin punonjësit e zyrës së ILD-së gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të ILD-së. Ky Plan mbështetet dhe i vjen në ndihmë respektimit të parimeve mbi të cilat organizohet dhe funksionon Zyra e ILD-së si: hierarkia, llogaridhënia, ligjshmëria, efektiviteti, paanësia, mos-diskriminimi, si dhe bashkëpunimi. Gjithashtu, përmirësimi i performancës së institucionit, rritja e transparencës e llogaridhënies, integriteti dhe profesionalizmi në ushtrimin e detyrave, kontribuojnë në përmirësimin e imazhit të institucionit dhe rrjedhimisht, në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucionit dhe sistemit të drejtësisë.

Për sa më sipër, qëllimi i Planit të Integritetit të Zyrës së ILD është konsolidimi i një sistemi të brendshëm të menaxhimit të integritetit për të eliminuar rrethanat dhe minimizuar rreziqet e sjelljeve jo etike, jo profesionale dhe veprimeve korruptive të të gjithë punonjësve të Zyrës së ILD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Plani i Integritetit do të sjellë si rezultat përmirësime të rëndësishme në mirë funksionimin dhe mirë qeverisjen e institucionit, konkretisht në:

- ✦ Përmirësimin e kuadrit ligjor rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të Zyrës së ILD me qëllim forcimin e integritetit institucional;
- ✦ Përmirësimin e procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit me qëllim rritjen e besimit të publikut tek veprimtaria e ILD;
- ✦ Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për ti rezistuar shkeljeve të integritetit;
- ✦ Përmirësimin e transparencës institucionale dhe konsolidimi i besimit të publikut;
- ✦ Përmirësimin e mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar
- ✦ Përmirësimin e teknologjisë së informacionit dhe administrimit e ruajtjes së dokumenteve digjitale

2. Metodologjia dhe procesi i hartimi të Planit të Integritetit

Sa i takon metodologjisë së përdorur për hartimin e Planit të Integritetit të ILD është përzgjedhur të përdoret *metoda mikse* duke kombinuar metodën cilësore me atë sasiore.

Metoda cilësore përfshiu analizën e kuadrit ligjor, kuadrit rregullator të brendshëm dhe strategjik, si dhe dokumenteve të ndryshme të punës të ILD (raportet vjetore të institucionit, rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, raportet e zbatimit të planit strategjik, struktura organizative dhe përshkrimet e punës, komunikimi dhe transparenca, raporte dhe analiza mbi veprimtarinë e ILD, etj.). Ndërkohë, *metoda sasiore* u përdor përmes vlerësimit me anë të një pyetësoi të strukturuar, që përfshinte pyetje mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Në vijim do të shpjegojmë metodologjinë e përdorur sipas fazave përmes të cilave ka kaluar hartimi i planit.

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Si një hap i parë në procesin e hartimit të Planit të Integritetit ishte ngritja e grupit të punës me përfaqësues të të gjithë Drejtorive të Zyrës së ILD, përkatësisht me 5 anëtarë, kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Grupi i Punës u ngarkua me detyrën për vlerësimin e riskut të integritetit dhe hartimin e Planit të Integritetit të ILD me mbështetjen teknike të ekspertëve të Qendrës Evropiane për zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit. Në disa takime të grupit të punës u dakordësuan objektivat e Planit të Integritetit, metodologjia për hartimin e Planit, metodologjia e vlerësimit të riskut në institucion dhe plani i punës për hartimin e Planit.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit

Identifikimi i risqeve të integritetit, përfshin gjetjen, njohjen dhe përshkrimin e tyre në Zyrën e ILD.

Në përfundim të kësaj faze u përftua një listë gjithëpërfshirëse e atyre risqeve, që pengojnë arritjen e objektivave të vendosur, sipas proceseve të punës që kryen institucioni. Në vëmendje të grupit të punës ishte edhe identifikimi i faktorëve të riskut (të brendshëm ose të jashtëm të institucionit, që mundësojnë ose rrisin mundësinë e riskut të identifikuar). Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor, rregullator, strategjik, si dhe dokumenteve të ndryshme të punës të Zyrës së ILD.

Pas analizës së kryer nga grupi i punës, u hartua një pyetësor vlerësimi, për punonjësit e Zyrës së ILD mbi perceptimet dhe eksperiencat e tyre në lidhje me çështjet e etikës dhe integritetit në institucion, me qëllim mbledhjen e të dhënave sasiore nga secila drejtori apo struktura. Njëkohësisht, u hartua edhe një udhëzues i takimeve të fokusuara me punonjësit e drejtorive/strukturave të ndryshme të ILD sipas proceseve të punës të identifikuar, me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore. Gjatë këtij procesi u zhvilluan 10 takime të tilla.

Qëllimi i diskutimeve në takimet e fokusuara ishte identifikimi i ngjarjeve negative në realizimin e proceseve të punës si edhe për të vlerësuar risqet e integritetit dhe faktorët e tyre në kuadër të këtyre proceseve. Grupi i punës, me mbështetjen e ekspertëve të Qendrës Evropiane, vijoi me shpërndarjen e pyetësorit tek punonjësit e Zyrës së ILD dhe zhvillimin e fokus grupeve në punonjësit e Drejtorive të Zyrës së ILD (punonjësit e Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, Drejtorisë së Standardeve dhe Analizës, Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse si dhe me Njësinë e Ndihmësinspektorëve).

Pas mbledhjes së të dhënave nga pyetësorët dhe fokus grupet u vijua me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, si dhe faktorëve të rrezikut për proceset e punës sipas drejtorive të institucionit. Këto gjetje të analizës u diskutuan më në detaje në një takim të përbashkët të grupit të punës dhe të ekspertëve të Qendrës Evropiane.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

Gjatë kësaj faze të procesit, grupi i punës me mbështetjen e ekspertëve vlerësuan rrezikun dhe ngjarjet e mundshme, kategorizimin sipas faktorëve të riskut, mundësinë e ndodhjes së risqeve dhe ndikimin e tyre si dhe vlerësuan efektivitetin e masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe propozuan masat e reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuan diskutimet dhe mendimet e përcjella nga të gjithë Drejtoritë e ILD-së.

Pas këtij vlerësimi, grupi i punës me mbështetjen e ekspertëve hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre. Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën 2023-2025. Kostot financiare të këtij Plani do të mbulohen nga buxheti i ILD-së.

Kombinimi i dy metodave solli në këtë rast rezultatin e kërkuar me qëllim arritjen e një plani integriteti, që ti shërbejë realisht institucionit të ILD.

3. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi nr. 1 Përmirësimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) me qëllim forcimin e integritetit institucional

ILD ka miratuar dhe zbatuar Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Zyrës së ILD-së, 2020-2022, i cili është rishikuar me qëllim përfshirjen dhe zbatimin e objektivave strategjikë të përcaktuar nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025. Në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2021” të datës 14 korrik 2022, janë lënë për ndjekje dhe zbatim 11 rekomandime. Ndër të tjera, Kuvendi ka rekomanduar edhe *“rishikimin e objektivave të punës dhe hartimin e një plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologjie të bashkërenduar për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës”*. Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, me urdhrin nr. 63, datë 28/07/2022, të ILD “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit 2023-2025, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, u ngrit grupi i punës për hartimin e planit të ri strategjik të ILD-së, i cili ka hartuar draft planin strategjik, i cili është në proces konsultimi. Miratimi sa më i shpejtë i këtij dokumenti strategjik përbën një nga përparësitë e Zyrës së ILD me qëllim zbatimin e një kuadri strategjik të harmonizuar me sisteme të menaxhimit financiar dhe kontrollit, integritetit dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin operacional dhe garantimin e përmbushjes me efikasitet dhe efektivitet të përgjegjësisë dhe kompetencave.

Një nga sfidat e vazhdueshme të Zyrës së ILD që prej krijimit, mbetet plotësimi i vendeve vakante për inspektorë të profilit magjistrat. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme drejtuar KLGJ-së për shpallje të vendeve vakante, në përfundim të procedurave plotësimi i vendeve vakante vijon të mbetet problematik, ndaj janë vlerësuar si të nevojshme ndërhyrjet ligjore, me synim rritjen e prurjeve nga radhët e magjistratëve. Me qëllim adresimin e situatës, ILD i ka paraqitur Kuvendit të Shqipërisë propozimin për ndryshime në Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht ndryshimet e propozuara synojnë:

- ✚ njësimin e masës së shpërblimit për inspektorët magjistratë dhe jomagjistratë, si dhe pasqyrimin në dosjen përkatëse të hetimit disiplinor, të opinionit të inspektorit përgjegjës të ngarkuar me hetimin, në rastin e një mendimi të ndryshëm me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- ✚ rishikimin e kriterëve që duhet të përmbushin magjistratët për t’u komanduar në detyrën e inspektorit, pranë Zyrës së ILD, duke reduktuar vitet e përvojës në funksion;
- ✚ komandimin e përkohshëm të magjistratit që ka paraqitur kërkesë, deri në kryerjen e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës, ose shkurtimin e afateve për paraqitjen e kërkesave dhe përgatitjen e opinionit nga Këshillat;
- ✚ heqjen e kriterit për të pasur numër të barabartë inspektorësh magjistratë dhe jo magjistratë;

✦ trajtim të barabartë financiar për inspektorët jomagjistratë;

Duke qenë se kjo problematikë prek drejtpërsëdrejti mirëfunksionimin e institucionit dhe veprimtarinë parësore të tij (veprimtarinë inspektuese) është vlerësuar se për të adresuar këtë problematikë një sërë masash duhen ndërmarrë, të cilat shkojnë në drejtim të nxitjes së diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve ligjore të propozuara, parashikimit në buxhet të fondeve të nevojshme dhe plotësimit të vendeve vakante në përputhje me parashikimet e reja ligjore të miratuara.

Për sa i përket kuadrit rregullator, ILD ka hartuar dhe miratuar një sërë rregulloresh duke krijuar kështu një kuadër të plotë rregullator dhe rregulla të detajuara lidhur me etikën dhe integritetin në institucion. Mund të përmendin Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Zyrës së ILD¹, Rregulloren e sjelljes dhe standardeve të etikës në zyrën e ILD², Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në zyrën e ILD³, Rregulloren për hetimin administrativ të kërkesës për sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Zyrën e ILD⁴, Rregulloren për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë⁵, etj. Punonjësit e Zyrës së ILD janë të njohur dhe disponojnë njohuritë e nevojshme lidhur me kuadrin rregullator si dhe ky i fundit është i publikuar në faqen web të ILD⁶.

Megjithatë, dhe me qëllim forcimin e mekanizmave të etikës dhe integritetit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të organizimit dhe funksionimit të institucionit është vlerësuar i nevojshëm rishikimi/përditësimi i Rregullosës së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Zyrës së ILD duke marrë në konsideratë ristrukturimin e ILD⁷, përshkrimin e detyrave të punës sipas drejtorive dhe sektorëve apo edhe plotësimin e saj me parashikime mbi konsultimin publik të projekt-akteve dhe marrëdhënies së ILD-së me publikun dhe median. Në të njëjtën mënyrë është vlerësuar e nevojshme edhe rishikimi/përditësimi i Hartës së Proceseve Kryesore të Punës të Zyrës së ILD.

Duke u angazhuar plotësisht në kryerjen e kontrollit të brendshëm në mënyrë periodike dhe rritjen e performancës së institucionit, me ristrukturimin e ILD është krijuar një Drejtori (Drejtoria e Analizës dhe Standardeve) që ka për qëllim realizimin me cilësi të proceseve të vazhdueshme në fushat e punës analizuese e kërkimore për standardizimin e procesit të punës në çdo strukturë nëpërmjet përgatitjes së manualeve të brendshme dhe standardeve specifike me qëllim

¹ Urdhër nr. 119, datë 12.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullosës së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

² Urdhër nr. 56, datë 07.07.2022, “Për miratimin e rregullave të sjelljes dhe standardeve të etikës në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

³ Urdhër nr. 64, datë 25.09.2020, “Për miratimin e rregullosës “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

⁴ Urdhër nr. 102, datë 14.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullosës për hetimin administrativ të kërkesës për sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

⁵ Urdhër nr. 103, datë 14.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullosës për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

⁶ <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

⁷ sipas Vendimit të Kuvendit nr.10/2023

përcaktimin, përditësimin dhe analizimin e indikatorëve që masin performancën e institucionit në mënyrë periodike, do të mundësojë që raportet, analizat, informacionet etj., të shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim rritjen e efikasitetit dhe uljen e çdo risku të mundshëm që ndikon në performancën e ILD-së si dhe qëllimit të krijimit të tij, si dhe grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore me qëllim realizimin e raporteve me informacionin e nevojshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit. Nisur jo vetëm nga krijimi i kësaj Drejtorie, por edhe nga qëllimi i krijimit të saj është vlerësuar i nevojshëm hartimi i dokumenteve që do të mbështesnin punën e ILD në këtë drejtim si:

- ✦ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit statistikor;
- ✦ Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së ILD-së.

Një problematikë tjetër e përkohshme por, që ndikon ndjeshëm në zhvillimin normal të veprimtarisë së ILD janë edhe ambientet dhe kushtet e punës aktuale të punonjësve të zyrës së ILD si rrjedhojë e rikonstruksionit të ambienteve ku duhet të ushtrojë veprimtarinë ILD. Përfundimi i rikonstruksionit të ambienteve dhe blerja e pajisjeve/bazës logjistike të nevojshme kërkon sigurimin e fondeve shtesë në buxhetin e ILD. Gjithashtu, kushtet infrastrukturore aktuale të arkivit sjellin problematika lidhur me ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve (dëmtimi i dokumenteve), si dhe ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të klasifikuara (zona e klasifikuar). Përfundimi i rikonstruksionit të ambienteve është tepër i rëndësishëm pasi puna në kushtet aktuale cenon jo vetëm ushtrimin e duhur të veprimtarisë, por edhe imazhin për institucionin dhe besimin e publikut. Rikonstruksioni dhe pajisja me logjistikën e nevojshme duhet të jetë e plotë dhe të mos shtyhet për arsye të mungesës së fondeve për vitet në vijim.

Objektivi nr. 2: Përmirësimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit me qëllim rritjen e besimit të publikut tek veprimtaria e ILD-së

Vlerësimi i performancës së inspektorëve është një proces i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit në mënyrë të vazhdueshme të etikës dhe aftësive profesionale të inspektorëve, të vendosjes së standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së tyre, të rritjes së vlerave profesionale dhe të integritetit të inspektorëve, të identifikimit të nevojave për trajnim vazhduesh, etj. Gjatë vitit 2022, janë përgatitur aktet e nevojshme për fillimin e vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve⁸. Që prej krijimit të institucionit, vlerësimi i parë i performancës së inspektorëve pritet të zhvillohet gjatë vitit 2023, si një prej prioriteteve kryesore të këtij viti.

Veprimtaria profesionale dhe etika e inspektorit të Zyrës së ILD vlerësohet nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit (KEV), i cili është ngritur dhe përbëhet nga tre anëtare sipas kërkesave të pikës 1, të nenit 212, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të

⁸ Vendim nr. 38, datë 08.06.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve", ndryshuar me Vendimin nr. 57, datë 30.12.2022.

ndryshuar. Vështirësitë në plotësimin e vendeve vakante për inspektorë të profilit magjistrat⁹ ka sjellë si vështirësi edhe pamundësinë për të përzgjedhur 2 anëtarët zëvendësues të KEV, mangësi që do të duhet të plotësohet në vijim me qëllim zbatimin e duhur të parashikimeve të nenit 212, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Një problematikë tjetër e rëndësishme me të cilën është përballur ILD, që prej krijimit të saj është ulja e numrit të ankesave të trashëguara nga institucione të tjera, që i administronin ato para ngritjes së ILD-së (*backlog*). Përfundimi sa më i shpejtë i ankesave të *backlog* përbën një prioritet tjetër të rëndësishëm në punën e ILD me qëllim shmangien e kulturës së harresës e pandëshkueshmërisë, që do vinte përmes parashkrimit të ankesave që qytetarët kishin paraqitur përpara ngritjes së institucionit të ILD. Nisur nga ky qëllim dhe për të adresuar këtë problematikë, e cila lidhet ngushtë edhe me plotësimin e vendeve vakante për inspektorë, ILD vendosi si prioritet trajtimin e ankesave të *backlog-ut*, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023. Intensifikimi i punës në këtë drejtim ka sjellë vonesa në trajtimin e ankesave të reja të ardhura në ILD. Kjo situatë sjell si pasojë riskun për krijimin e një *backlogu* të ri ndaj edhe është tepër e rëndësishme, që ky risk të shmanget nëpërmjet marrjes së masave të nevojshme si: përfundimi sa më i shpejtë i trajtimit të ankesave të *backlog*, trajtimi me prioritet i ankesave të cilave i kanë kaluar afatet kohore të shqyrtimit/trajtimit si dhe forcimin e bashkëpunimit me KLGJ, KLP, gjykatat dhe prokuroritë në përcjelljen në kohë të informacionit të plotë të kërkuar në kuadër verifikimit të ankesës dhe hetimit të rastit.

Për sa i përket inspektimeve tematike, neni 194, pika 4, ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, parashikon se "*Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve*". Një nga problematikat e hasura deri më tani në lidhje me inspektimet tematike është mungesa e kërkesave të motivuara me shkrim për inspektime tematike nga KLGJ, KLP dhe Ministrisë së Drejtësisë drejtuar ILD. Përveç paraqitjes së kërkesave të vazhdueshme drejtuar këtyre institucioneve me qëllim përcjelljen e tematikave apo çështjeve, që vlerësohen se ka nevojë për inspektim, shihet i nevojshëm edhe organizimi i takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e institucioneve, në rast të mungesës së përgjigjes nga ana e tyre, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe diskutimin mbi tematikat apo çështjet, që kanë nevojë për inspektim.

Rritja e kapaciteteve profesionale të inspektorëve është një tjetër prioritet i rëndësishëm i ILD. Deri më tani inspektorët kanë përfutuar trajnime të ndryshme të organizuara nga partnerët ndërkombëtarë. Megjithatë, ofrimi i trajnimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas nevojave mbetet një sfidë, pasi nuk ka kurrikula apo mekanizma, që në mënyrë permanente të ofrojnë trajnime në fushën e inspektimeve. Ndërkohë, që inspektorët magjistratë përfitojnë nga programi i trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës, nuk ka program trajnimi për inspektorët jomagjistratë.

⁹ Duke qenë se vlerësimi i performancës për inspektorët jomagjistrat nuk është kryer ende, atëherë vetëm inspektorët magjistratë plotësojnë kërkesën e nenit 212, të ligjit nr. 115/2016, lidhur me vlerësimin "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit etiko-profesionale.

Edhe programi i trajnimit të Shkollës së Magjistraturës nuk përputhet me nevojat për trajnim të inspektorëve lidhur me hetimin disiplinor dhe inspektimin. Situata paraqitet e njëjtë edhe për ndihmës-inspektorët, të cilët përfitojnë nga programi i trajnimeve të ASPA, i cili jo gjithmonë është në përputhje me nevojat e identifikuar për trajnimin e tyre. Ndryshimet në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përfshijnë një përgjegjësi tjetër për ILD të përcaktuar në nenin 124/1 lidhur me verifikimin e pasurisë dhe figurës të subjekteve të procedimit disiplinor. Kjo përgjegjësi kërkon, që inspektorët dhe ndihmës-inspektorët të zotërojnë kapacitetet e duhura për të kryer verifikimin e pasurisë dhe figurës të subjekteve të procedimit disiplinor. Ndaj, nisur nga këto nevoja është vlerësuar i përshtatshëm bashkëpunimi me institucione publike, që kanë kapacitetet dhe mundësitë të ofrojnë programe trajnimi të vazhdueshme për inspektorët dhe ndihmës-inspektorët sipas një kalendarit të dakordësuar dhe të miratuar. Duke qenë se shkëmbimi i eksperiencave me institucionet homologe konsiderohet si një praktikë shumë efektive për thellimin e njohurive të inspektorëve dhe ndihmës-inspektorëve në fushën e hetimit disiplinor, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë vlerësohet si mënyra më e mirë për të realizuar aktivitete të kësaj natyre.

Objekti nr.3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore, Zyra e ILD është e angazhuar plotësisht në zbatimin e legjislativës në fuqi për plotësimin e vendeve të lira rregullimin e marrëdhënieve të punës, procedurave të qarta për marrjen dhe dorëzimin e detyrës, etj. Siç e theksuam, Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së ILD përmban parashikime të detajuara lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë sipas strukturave të ILD por, që pas ristrukturimit të institucionit, në fillim të vitit 2023, nevojitet një rishikim i Rregullores sipas strukturës së re të miratuar.

Në të njëjtën kohë, një element i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Zyrës së ILD, si në aspektin teknik ashtu dhe atë të etikës dhe integritetit nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një plani të plotë të trajnimeve të nevojshme të identifikuar. Me rëndësi në drejtim të forcimit të etikës dhe integritetit të punonjësve janë sidomos trajnimet lidhur mbi etikën dhe integritetin në institucion, konfliktin e interesave, identifikimin dhe vlerësimin e riskut, sigurinë e informacionit, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, kufizimet e drejtës për informim, etj. Ndërkohë, që për forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve janë vlerësuar të nevojshëm trajnimet mbi Kodin e Procedurës Administrative dhe hetimin administrativ (metodat dhe hapat që ndiqen), teknikën legjislativë dhe paketa e akteve të Reformës në Drejtësi. Çdo vit, ILD përcakton kalendarin e trajnimeve vjetore sipas nevojave të identifikuar nga strukturat e saj, megjithatë zbatimi i kalendarit shpesh është i vështirë pasi i vetmi institucion, që ofron trajnime është ASPA dhe sikurse nënvizuam dhe më lart, ky programi trajnimi jo gjithmonë përkon me nevojat e identifikuar. Ndaj, ILD në vijim angazhohet të parashikojë në buxhet një fond për zhvillimin e trajnimeve, që nuk mbulohen nga ASPA, të bashkëpunojë me donatorë/organizata të

ndryshme për zhvillimin e disa nismave për rritje kapacitetesh, si dhe për disa tema të caktuara trajnimet të ofrohen nga vetë punonjësit e Zyrës së ILD-së sipas përgjegjësiive respektive.

Objektivi nr.4 Përmirësimi i transparencës institucionale dhe konsolidimi i besimit të publikut

Transparenca në informacion është në qendër të komunikimit publik të Zyrës së ILD dhe thelbësor për imazhin, që institucioni gëzon tek qytetarët, por edhe për rritjen e besimit të publikut tek veprimtaria e institucionit. Në këtë kuadër është miratuar Programi për Informimin dhe Komunikimin Publik 2022-2023, si një dokument udhëzues i veprimtarisë së informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut. Prej krijimit të ILD-së, por edhe në zbatim të Programi për Informimin dhe Komunikimin Publik 2022-2023 një sërë aktiviteteve janë zbatuar dhe kanale të ndryshme të komunikimit janë përdorur për të përcjellë informacionin tek publiku i grup-moshave të ndryshme. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, vërehet se qytetarët/ankuesit kanë ende njohuri të kufizuara, lidhur me objektin e veprimtarisë së ILD dhe paraqitjen e ankesave. Ndaj, ILD do të vazhdojë përpjekjet në drejtim të informimit dhe edukimit të publikut, nëpërmjet jo vetëm zbatimit të Programit aktual për Informimin dhe Komunikimin Publik, por edhe nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Programit për vitet në vijim (2024-2025) mbështetur në një vlerësim paraprak të nevojave dhe duke përdorur kanale komunikimi, që kanë shikueshmëri të lartë dhe arrijnë grup-mosha të ndryshme. Kështu, bashkëpunimi me median dhe përdorimi i rrjeteve sociale shihet si një mundësi e mirë për të përcjellë informacionin e nevojshëm.

Zyra e ILD, ka përmbushur detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” lidhur me kërkesat për informim, miratimit të Programit të Transparencës, caktimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe plotësimit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Faqja zyrtare e internetit www.ild.al mundëson qasje në kohë reale, në shqip dhe anglisht me informacionin dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Përmes faqes së internetit, Zyra e ILD ka vendosur marrëdhënie proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median. Informacioni i bërë publik në programin e transparencës, pasqyron në mënyrë shteruese veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare www.ild.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Përditësimi dhe plotësimi i informacionit në faqen zyrtare të internetit të ILD-së dhe i Programit të Transparencës janë në vëmendjen e Zyrës së ILD-së për të siguruar një informacion sa më të plotë për tërësinë e veprimtarisë së ILD, ndaj përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme i Programit të Transparencës së ILD mbetet prioritet.

Objektivi nr.5 Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar

Prej krijimit të institucionit, janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh, që kanë për qëllim të ngrënë dhe zhvillojnë sistemin e planifikimit, menaxhimit dhe kontrollit financiar. Buxheti i ILD ndër vite ka ardhur në rritje por ka mbuluar shpenzimet e domosdoshme të këtij institucioni. Ndërkohë, që për të siguruar funksionimin normal të ILD është i nevojshëm sigurimi dhe mbulimi i shpenzimeve shtesë për përfundimin e rikonstruksionit të ambienteve të godinës, blerjen e pajisjeve për zyra, krijimin e dhomës së serverave sipas standardeve të përcaktuara, pajisjen me licenca për sistemin SMAD, si dhe shtesa në fondin e pagave të inspektorëve magjistratë. Për të mbuluar këto shpenzime, tavanet buxhetore të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) janë vlerësuar të pamjaftueshme. Për rrjedhojë, zyra e ILD i ka paraqitur MFE kërkesat për shtesë buxheti. Për vitet në vijim, Zyra e ILD do të vijojë dhe intensifikojë diskutimet dhe takimet me MFE, paraprkisht përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe projektbuxhetit, me qëllim përcaktimin e taveve të nevojshme të shpenzimeve dhe marrjen në konsideratë të kërkesave shtesë.

Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar synohen të përmirësohen nëpërmjet hartimit dhe miratimit të disa dokumenteve të rëndësishme, si rrjedhojë e nevojave të identifikuara dhe gjetjeve/rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm, si:

- ✦ Udhëzuesit të brendshëm për Monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për Zyrën e ILD-së;
- ✦ Udhëzimit mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik për Zyrën e ILD-së;
- ✦ Strategjisë së Menaxhimit të Riskut për Zyrën e ILD
- ✦ Urdhrit për Ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut për Zyrën e ILD-së;
- ✦ Rishikimi/plotësimi i Regjistrit të Riskut dhe Matricës së Riskut për Zyrën e ILD;
- ✦ Plani i masave për minimizimin e riskut;

Me ristrukturimin e fundit të ILD, struktura e auditimit të brendshëm është suprimuar duke krijuar kështu një vakum në strukturat e kontrollit të brendshëm. Për të plotësuar këtë vakum Zyra e ILD, në përputhje me parashikimet e nenit 10/c/ç të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ka njoftuar MFE lidhur me sigurimin e auditimit të brendshëm dhe në vijim, do të intensifikojë kërkesat për të siguruar këtë kontroll sipas parashikimeve ligjore.

Objektivi nr.6 Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe administrimit e ruajtjes së dokumenteve digjitale

Zhvillimi i infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit ka qenë gjithashtu në fokus të punës së ILD. Me mbështetjen e projektit Euralius V është krijuar sistemi elektronik i brendshëm për menaxhimin e ankesave (SMAD), i cili është duke u përdorur nga inspektorët, ndihmës inspektorët dhe arkiv protokollit në përputhje me rregullat e përcaktuara për administrimin dhe përdorimin e

tij¹⁰. Me qëllim funksionimin e sistemit, Zyra e ILD ka marrë masa për të kërkuar buxhet shtesë për pajisjen me licenca vjetore.

Përveç sa më sipër, ILD ka hartuar dhe miratuar rregullat e sigurisë në mbrojtje të informacionit, që administrohet nga të gjithë strukturat e Zyrës së ILD me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aktiveve të teknologjisë dhe zbatimin e masave teknike dhe organizative për të ruajtur sigurinë e aktiveve nga kërcënime reale apo potenciale, që prekin sistemet elektronike dhe ato të arkivimit të informacionit. Megjithatë, dhe në kushtet kur rikonstrukcioni i ambienteve të ILD nuk ka përfunduar ende, dhoma aktuale e serverave nuk është krijuar sipas parametrave të nevojshëm dhe nuk përmbush kushtet e sigurisë. Gjithashtu, edhe projekti aktual për dhomën e serverave në ambientet e rikonstruara nuk përmbush plotësisht standardet e përcaktuara për ndërtimin dhe administrimin sipas kërkesave të Bordit Drejtues i Qendrës Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë¹¹. Në këto kushte, një sërë masash do të ndërmerren nga Zyra e ILD për të siguruar rishikimin e projektit të rikonstrukcionit të ambienteve të ILD me qëllim përshtatjen e dhomës së serverave sipas standardeve të përcaktuara dhe sigurimin e fondeve të nevojshme. Për sa i përket sistemit të arkivimit, Zyra e ILD do të angazhohet në hartimin e Analizës së Riskut të Sistemit të Arkivimit dhe Gjendjes së Sigurisë në të cilën identifikohen kërcënimet që prekin pjesë individuale të sistemit të arkivimit, të afta të shkelin sigurinë apo funksionimin e tij.

¹⁰ Urdhër nr. 59, datë 15.07.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

¹¹ Vendim i datës 19/12/2022;

4. Plani i veprimit

Plani i Veprimit, përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së ILD. Ai përmban përshkrime për masat specifike, që do të zbatohen për të arritur 6 objektivat e Planit të Integritetit. Zbatimi i Planit të Integritetit do të pasohet nga procesi i raportimit dhe monitorimit të tij.

Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas parashikimeve dhe afateve kohore të përcaktuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit, minimalisht çdo 6 muaj. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Monitorimi është periodik vjetor dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimave për planifikim më të mirë në të ardhmen.

PLANI I INTEGRITETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË 2023 - 2025

Objektivi nr. 1 Përmirësimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) me qëllim forcimin e integritetit institucional						
Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Rreziku i mundshëm	Kontrolli (Rekomandimet)	Struktura përgjegjëse për zbatimin e masës	Afati i realizimit
1.	Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit të Zyrës së ILD-së, 2023-2025, nuk është miratuar ende;	Strategjik/ Veprimtaria	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Miratimi i Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Zyrës së ILD, 2023-2025; Rishikimi/përditësimi i dokumenteve të tjerë të ILD-së në përputhje me parashikimet strategjike të miratuara; Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit. 	ILD; Sekretari i Përgjithshëm; Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike në bashkëpunim me inspektorët dhe strukturat e tjera të ILD.	2023 dhe në vazhdimësi
2.	Numri i inspektorëve magjistratë të komanduar pranë ILD vijon të mbetet i ulët krahasuar me vendet vakante; Trajtimi jo i barabartë financiar midis	Ligjor/ Veprimtaria Inspektuese	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> Vijimi i kërkesave të vazhdueshme drejtuar KLGJ dhe KLP për shpallje të vendeve vakante për komandimin e inspektorëve magjistratë pranë ILD; Ndjekja e procedurës parlamentare për ndryshimet ligjore të propozuara pranë Kuvendit të Shqipërisë; Parashikimi në buxhet apo paraqitja e kërkesës për fond shtesë si rrjedhojë e 	Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	1- çdo 6-muaj; 2-në vazhdimësi sipas agjendës së Kuvendit

	inspektorëve magjistratë dhe atyre jo magjistratë;			njësimit të pagave midis inspektorëve magjistratë dhe atyre jo magjistratë; 4. Plotësimi i vendeve vakante në përputhje me parashikimet e reja ligjore të miratuara.		3 dhe 4- menjëherë pas miratimit të ndryshimeve ligjore
3.	Urdhri nr. 119, datë 12.07.2021, i ILD "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, nuk është i përditësuar/rishikuar	Rregullator/ Veprimtaria	Mesatar	Rishikimi/përditësimi i Urdhrit të ILD nr. 119, datë 12.07.2021, duke marrë në konsideratë: <ul style="list-style-type: none"> Ristrukturimin e ILD sipas Vendimit të Kuvendit nr.10/2023; Suprimimin e rregullimit për Njësinë e Auditimit të Brendshëm; Rishikimi për sa i përket ngritjes së njësisë përgjegjëse për sinjalizuesit; Përshkrimin e detyrave të punës sipas drejtorive dhe sektorëve; Parashikimin e rregullave mbi konsultimin publik të projekt-akteve dhe marrëdhënies së ILD-së me publikun dhe median. 	Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike/Sektori i Hartimit të Akteve dhe Përputhshmërisë, në bashkëpunim me strukturat e tjera të ILD	2023
4.	Harta e Proceseve Kryesore të Punës të Zyrës së ILD nuk është e përditësuar/rishikuar;	Rregullator/ Veprimtaria	Mesatar	Rishikimi/përditësimi i Hartës së Proceseve Kryesore të Punës të Zyrës së ILD, duke marrë në konsideratë ristrukturimin e ILD sipas Vendimit të Kuvendit nr.10/2023 dhe suprimimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.	Zyra e ILD	2023
5.	Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe	Veprimtaria	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i Metodologjisë së mbledhjes të të dhënave dhe përpunimit statistikor që përcakton të paktën:	Drejtoria e Analizës dhe Standardeve/Sekt	Viti 2023 e në vijim

	përpunimit statistikor nuk është e hartuar;			<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurimi i informacionit të plotë statistikor dhe në kohë reale lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/çështjeve kryesisht të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga strukturat përkatëse pjesë e këtij procesi. 2. Afatet e grumbullimit të informacionit statistikor dhe Formularët e grumbullimit dhe përpunimit të bazës së të dhënave. 	ori i Metodikës dhe Standardeve	
6	Metodologjia e analizës dhe Raportimit të informacionit statistikor		Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Analizimi në kohë reale dhe raportimi periodik i informacionit statistikor që lidhet me ankesat drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe të strukturave përkatëse pjesë e këtij procesi. 2. Përgatitja e buletineve periodike mujore, 3 mujore. 3. Përgatitja e Vjetarit Statistikor 4. Përgatitja e Buletinit Vjetor të Vendimeve të marra nga ILD etj. 	Drejtoria e Analizës dhe Standardeve/Sektori i Metodikës dhe Standardeve	Viti 2023 e n ^o 7 vijim

7.	Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së ILD-së nuk është e hartuar;	Veprimtaria/ Reputacioni	Mesatar	<p>Hartimi dhe miratimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së ILD-së që përcakton: kriteret dhe treguesit e vlerësimit/korniza e vlerësimit të performancës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • nivelet e vlerësimit; • mënyrat dhe teknikat e vlerësimit të performancës; • analizën e rezultateve; • hartimin i raportit të vlerësimit, etj; • trajnimi i punonjësve të ILD. 	Drejtoria e Analizës dhe Standardeve/Sektori i Metodikës dhe Standardeve në bashkëpunim me strukturat e tjera të ILD	2024 dhe në vazhdimësi
8.	Rikonstruksioni i ambienteve ku duhet të ushtrojë veprimtarinë ILD nuk ka përfunduar ende dhe kushtet aktuale të punës pengojnë zhvillimin normal të veprimtarisë;	Veprimtaria	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurimi i fondeve shtesë të kërkuara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) të nevojshme për përfundimin e rikonstruksionit të godinës së ILD dhe blerjen e pajisjeve/bazës logjistike të nevojshme; 2. Zhvillimi i procedurës së prokurimit dhe kontraktimit të subjektit që do të furnizojë institucionin me bazën logjistike; 3. Krijimi i kushteve infrastrukturore të përshtatshme dhe pajisjen me zyra e ambiente pune i të gjithë punonjësve të ILD-së sipas strukturës dhe organikës së miratuar dhe menjëherë pas rikonstruksionit të godinës; 4. Pajisja e punonjësve me bazën logjistike të nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë; 	Sekretari i Përgjithshëm Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse	2023-2024

9.	Kushtet infrastrukturore aktuale të arkivit sjellin problematika lidhur me ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve (dëmtimi i dokumenteve)	Veprimtaria	I lartë	1. Krijimi i kushteve infrastrukturore të përshtatshme për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të arkivit menjëherë pas rikonstruksionit të godinës;	Sekretari i Përgjithshëm Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse	2023-2024
Objektivi nr. 2: Përmirësimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit me qëllim rritjen e besimit të publikut tek veprimtaria e ILD						
Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Rreziku i mundshëm	Kontrolli (Rekomandimet)	Struktura përgjegjëse për zbatimin e masës	Afati i realizimit
1.	Vlerësimi i etikës(dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve nuk është kryer ende;	Veprimtaria	I lartë	1. Nisja e procedurave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve; 2. Kryerja e vlerësimit për periudhën e parë sipas procedurës dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve të përcaktuar në Vendimin nr. 38, datë 08.06.2022, i ndryshuar; 3. Rishikimi/përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit të performancës së inspektorëve sipas nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të metodologjisë së vlerësimit për periudhën e parë; 4. Hartimi dhe miratimi në vijimësi i Programit Vjetor të Vlerësimit;	Inspektori i Lartë i Drejtësisë; Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit; Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	2023 dhe në vazhdimësi

				<p>5. Kryerja e vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve në vijimësi sipas metodologjisë së përcaktuar;</p> <p>6. Ngritja e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit (KEV) sipas kërkesave dhe procedurave të parashikuara në pikën 1, të nenit 212, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, (zgjedhja e anëtarëve zëvendësues dhe hedhja e shortit për ngritjen e KEV për vitin pasardhës).</p>		
2.	Trajtimi i ankesave nuk arrihet gjithmonë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara, për arsye të backlog të trashëguar dhe vakancave	Veprimtaria/ Reputacioni	I lartë	<p>1. Përfundimi sa më i shpejtë i trajtimit të ankesave të <i>backlog</i>;</p> <p>2. Trajtimi me prioritet i ankesave të cilave i kanë kaluar afatet kohore të shqyrtimit/trajtimit me qëllim shmangien e krijimit të një <i>backlog-u</i> të ri;</p> <p>3. Forcimi i bashkëpunimit me KLGJ, KLP, gjykatat dhe prokuroritë në përcjelljen në kohë të informacionit të plotë të kërkuar në kuadër verifikimit të ankesës dhe hetimit të rastit;</p> <p>4. Në vijimësi, trajtimi brenda afateve të përcaktuara i ankesave.</p>	Njësia e inspektoreve dhe ndihmësinsektorëve	2023 dhe në vazhdimësi
3.	Mungesa e kërkesave të motivuara me shkrim nga KLGJ, KLP dhe Ministria e Drejtësisë për kryerjen	Veprimtaria	Mesatar	1. Paraqitja e kërkesave të vazhdueshme drejtuar këtyre institucioneve me qëllim përcjelljen e tematikave apo çështjeve që vlerësohen se ka nevojë për inspektim;	Inspektori i Lartë i Drejtësisë Inspektorët	Në vazhdimësi dhe përpara hartimit të Planit Vjetor të Inspektiveve;

	e inspektiveve institucionale dhe tematike;			2. Organizimi i takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e institucioneve në rast të mungesës së përgjigjes nga ana e tyre me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe diskutimin mbi tematikat apo çështjet që vlerësohen se ka nevojë për inspektim;		
4.	Kalendari i trajnimeve për inspektorët jo magjistatë mungon; Trajnimet në fushën e hetimit disiplinor dhe inspektiveve nuk ofrohen në mënyrë të vazhdueshme sipas një kalendari të përcaktuar;	Veprimtaria	I lartë	1. Trajnimi i vazhdueshëm i inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve sipas kalendarit të miratuar; 2. Bashkëpunimi me donatorët dhe organizatat me qëllim thellimin e njohurive të inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve në fushën e hetimit disiplinor dhe inspektiveve nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet homologe;	Inspektori i Lartë i Drejtësisë Inspektorët/ndihmës inspektorët Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2023 dhe në vazhdimësi
5	Njohuri të pamjaftueshme të inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve për verifikimin e pasurisë dhe të figurës të subjekteve të procedimit disiplinor;			Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis ILD dhe ILDKPKI për zhvillimin e kapaciteteve të inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve lidhur me procesin verifikimin e pasurisë dhe të figurës; Mbajtja e takimeve/tryezave të përbashkëta për inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve sipas tematikave të		

				dakordësuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit;		
Objektivi nr.3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për ti rezistuar shkeljeve të integritetit						
Nr	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Rreziku i mundshëm	Kontrolli (Rekomandimet)	Struktura përgjegjëse për zbatimin e masës	Afati i realizimit
1.	Nevoja për thellim të njohurive dhe rritje të kapaciteteve të punonjësve të Zyrës së ILD-së në fusha të ndryshme;	Veprimtaria/ Reputacioni	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Parashikimi në kalendarin e trajnimeve të punonjësve të Zyrës së ILD të trajnimeve mbi etikën dhe integritetin ne institucion, konfliktin e interesave, identifikimin dhe vlerësimin e riskut, sigurinë e informacionit, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, kufizimet e drejtës për informim, Kodin e Procedurës Administrative dhe hetimin administrativ (metodat dhe hapat që ndiqen), teknikën legjislativë dhe paketa e akteve të Reformës në Drejtësi; Bashkëpunimi me ASPA për mbulimin e disa trajnimeve; Parashikimi në buxhet i një fondi për zhvillimin e trajnimeve që nuk mbulohe nga ASPA; Përcjellja e nevojave për trajnim tek donatorë/organizata të ndryshme dhe bashkëpunimi për zhvillimin e disa trajnimeve; 	Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Burimeve Njerëzore	2023 dhe në vazhdimësi

Objektivi nr.4 Përmirësimi i transparencës institucionale dhe konsolidimi i besimit të publikut						
Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Rreziku i mundshëm	Kontrolli (Rekomandimet)	Struktura përgjegjëse për zbatimin e masës	Afati i realizimit
1.	Njohuri të kufizuara të publikut lidhur me fushën e veprimtarisë së ILD dhe mbi paraqitjen e ankesave pranë ILD;	Veprimtaria	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Zbatimi i Programit për Informimin dhe Komunikimin Publik 2022-2023, sipas Urdhrit nr. 49, datë 30.05.2022; Hartimi i Programit për Informimin dhe Komunikimin Publik 2024-2025 në të cilin të parashikohen: <ul style="list-style-type: none"> Masat/veprimtaria e nevojshme sipas një vlerësimi paraprak të nevojave të publikut për informacion; Indikatorët matës së realizimit të masave/veprimtarive; Audienca e synuar sipas target-grupeve të ndryshme Kanalet e komunikimit sipas audiencës së synuar; Strukturat përgjegjëse për zbatimin e masës; Koha e realizimit; Burimi i financimit (buxhet i shtetit apo me mbështetje të donatorëve e organizatave); Parashikimi i aktiviteteve në bashkëpunim me median si një aktor i rëndësishëm në informimin dhe edukimin e publikut (intervista 	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p> <p>Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun</p> <p>Strukturat e tjera të ILD</p>	2023-2024

				<p>televizive, pjesëmarrje në emisione televizive, njoftim për median, paketa për median, artikuj dhe editoriale në median online, etj);</p> <p>4. Parashikimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere në mediat sociale;</p> <p>5. Shpërndarja e Programit të hartuar tek donatorët e organizatat me qëllim mbështetjen në zbatimin e Programit;</p> <p>6. Miratimi i Programit për Informimin dhe Komunikimin Publik 2024-2025;</p> <p>7. Publikimi i Programit në faqen web të ILD.</p>		
2.	Programi i Transparencës së ILD-të pasurohet me publikimin e informacionit pa kërkesë;	Ligjor/Imazhi	Mesatar	<p>Përditësimi i Programit të Transparencës dhe plotësimi me informacionin e nevojshëm, mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin e prokurimeve dhe regjistri e realizimeve për vitin 2022-2023; • zbatimin dhe monitorimin e kontratave; • raportet e auditimit të brendshëm/dokumente të performancës së ILD; • strategji apo plane veprimi mbi menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe riskun; 	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun	2023
Objektivi nr.5 Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar						
Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Rreziku i mundshëm	Kontrolli (Rekomandimet)	Struktura përgjegjëse për	Afati i realizimit

					zbatimin e masës	
1.	Tavanet buxhetore të përcaktuara nga MFE janë të pamjaftueshme dhe nuk mbulojnë nevojat imediate të ILD-së (rikonstruksioni i ambienteve të godinës, pajisje zyre, pagat e inspektorëve magjistratë, dhoma e serverave, licencat për sistemin SMAD	Veprimtaria	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> Takime të vazhdueshme me MFE dhe paraprkisht përgatitjes së PBA dhe projektbuxhetit me qëllim përcaktimin e taveaneve të nevojshme të shpenzimeve dhe në vijimësi për marrjen në konsideratë të kërkesave shtesë; Paraqitja e projektbuxhetit të ILD në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend duke përfshirë të gjithë shpenzimet e nevojshme dhe kërkesat shtesë; Pjesëmarrja në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar nga ILD; 	<p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm/Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Spektori i Buxhetit dhe Financës</p>	2023 dhe në vazhdimësi
2.	Struktura e auditimit të brendshëm është suprimuar me ristrukturimin e fundit të ILD, në shkurt 2023;	Veprimtaria/ Ligjore	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi i takimeve dhe diskutimeve me MFE lidhur me sigurimin e auditimit të brendshëm sipas parashikimeve të ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Sigurimi i auditimit të brendshëm sipas parashikimeve të nenit 10/c/ç të ligjit Nr. 114/2015; 	<p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm/Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse</p>	2023-2024
3.	Udhëzuesi i brendshëm për Monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për Zyrën e	Veprimtaria/ Rregullator	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit të brendshëm për Monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për Zyrën e ILD-së.	<p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm/Dre</p>	2023 dhe në vazhdimësi

	ILD-së nuk është hartuar;				jtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Buxhetit dhe Financës në bashkëpunim me strukturat e tjera të ILD.	
4.	Udhëzimi mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) për Zyrën e ILD-së konsiderohet i nevojshëm;	Veprimtaria	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik për Zyrën e ILD-së.	Inspektori i Lartë i Drejtësisë Sekretari i Përgjithshëm/Drejtorja Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Buxhetit dhe Financës.	2023 dhe në vazhdimësi
5.	Strategjia e Menaxhimit të Riskut për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është hartuar;	Veprimtaria/ Ligjor	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut për Zyrën e ILD. Publikimi i Strategjisë në faqen web të ILD-së. 	Inspektori i Lartë i Drejtësisë; Sekretari i Përgjithshëm/Drejtorja Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Buxhetit dhe Financës; Grupi i Menaxhimit Strategjik;	2023 dhe në vazhdimësi

					Strukturat e tjera të ILD.	
6.	Ekipi për Menaxhimin e Riskut për Zyrën e ILD-së nuk është ngritur;	Veprimtaria	I lartë	Përgatitja dhe miratimi i Urdhrit për Ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut për Zyrën e ILD-së	Inspektori i Lartë i Drejtësisë; Sekretari i Përgjithshëm/Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Buxhetit dhe Financës.	2023 dhe çdo fillim viti në vazhdimësi
7.	Regjistri i Riskut dhe Matrica e Riskut për Zyrën e ILD duhet rishikuar;	Veprimtaria	I lartë	Rishikimi/plotësimi i Regjistrit të Riskut dhe Matricës së Riskut për Zyrën e ILD bazuar në komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe pas miratimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Zyrës së ILD, 2023-2025.	Sekretari i Përgjithshëm/Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/Sektori i Buxhetit dhe Financës; Ekipi për Menaxhimin e Riskut për Zyrën e ILD-së; Strukturat e tjera të ILD.	2023 dhe në vazhdimësi
8.	Plani i masave për minimizimin e riskut nuk është hartuar;	Veprimtaria	I lartë	Hartimi dhe miratimi i Planit të masave për minimizimin e riskut sipas aneksit nr.3 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e	Sekretari i Përgjithshëm/Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve	2023 dhe në vazhdimësi

				koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.	Mbështetëse/ Sektori i Buxhetit dhe Financës; Ekipi për Menaxhimin e Riskut për Zyrën e ILD-së; Strukturat e tjera të ILD.	
9.	Vlerësimi i Aktiveve Afatgjatë të evidentuara në institucion pa vlerë fillestare nuk ka filluar.	Veprimtaria	I lartë	Zhvillimi i procesit të vlerësimit dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet menjëherë pas rikonstruksionit të godinës.	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Buxhetit dhe Financës/ Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme	2023-2024
Objektivi nr.6 Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe administrimit e ruajtjes së dokumenteve digjitale						
Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Rreziku i mundshëm	Kontrolli (Rekomandimet)	Struktura përgjegjëse për zbatimin e masës	Afati i realizimit
1.	Mungesa e licencave për sistemin SMAD	Veprimtaria	I lartë	Sigurimi i fondeve shtesë të kërkuara pranë MFE, me qëllim rinovimin e licencave përkatëse;	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Buxhetit	2024 dhe në vazhdimësi

				dhe Financës/ Sektori i Teknologjisë së Informacionit/ Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme Strukturat e tjera të ILD.		
2.	Projekti aktual për dhomën e serverave nuk përmbush plotësisht standardet e përcaktuara për ndërtimin dhe administrimin;	Veprimtaria/ Siguria e informacionit	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rishikimi i projektit të rikonstruksionit të ambienteve të ILD me qëllim përshtatjen e dhomës së serverave sipas standardeve të përcaktuara; 2. Llogaritja e fondit të nevojshëm sipas projektit të rishikuar; 3. Paraqitja e kërkesës pranë MFE për fonde shtesë; 4. Sigurimi i fondeve shtesë të kërkuara pranë MFE të nevojshme për krijimin e dhomës së serverëve sipas standardeve; 5. Zhvillimi i procedurës së prokurimit dhe kontraktimit të subjektit që plotëson kriteret për krijimin e dhomës së serverëve; 6. Krijimi i dhomës së serverëve sipas standardeve të përcaktuara. 	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Buxhetit dhe Financës/ Sektori i Teknologjisë së Informacionit/ Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme	2024 dhe në vazhdimësi
3.	Analiza e riskut të sistemit të arkivimit	Veprimtaria	I lartë	Hartimi i Analizës së riskut të sistemit të arkivimit dhe gjendjes së sigurisë sipas	Drejtoria Ekonomike dhe	2023-2024

	dhe gjendjes së sigurisë nuk është hartuar;			parashikimeve në nenin 21 të Urdhrit nr. 163, datë 22.12.2021 “Për miratimin e Rregullores mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit në zyrën e ILD-së”.	Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Teknologjisë së Informacionit.	
--	---	--	--	--	--	--